



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 179/2 Prot.

Rrëshen me, 02 . 02 . 2024

V E N D I M

Nr. 1 datë 31. 01. 2024

P Ë R

“MIRATIMIN E KRITEREVE SPECIFIKE, PËR FAMILJET APLIKUESE, QË NUK JANË SHPALLUR PËRFITUES, NGA SISTEMI I PIKËZIMIT, TË CILAT DO TRAJTOHEN NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6%, OSE ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR” BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së, nr. 597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike, pas verifikimit real, nga administratorët social, të çdo njësi administrative nga sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale, kryetari i bashkisë propozon këshillit bashkiak Mirditë, kriteret specifike për familjet aplikuese, që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit të cilat do trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën deri në 6%, ose me fonde të buxhetit vendor, bashkia Mirditë, pas diskutimeve në séancë të këshillit bashkiak Mirditë;

V E N D O S I:

- A. Miratimin e kriteret specifike, për familjet aplikuese, që nuk janë shpallur përfitues, nga sistemi i pikëzimit, të cilat do trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 % ose me fondet e buxhetit vendor, bashkia Mirditë, si më poshtë vijon:
1. Viktimat e dhunës që ju ka mbaruar afati i vlefshmërisë të urdhërit të mbrojtjes të përcaktuar në vendimin e gjykatës dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose nuk kanë të ardhura.
 2. Vajzat nëna me fëmijë të mitur edhe pse mund të jetojnë me anëtarë të tjerë të familjes, të cilëve nuk u është njohur atësia dhe kujdesi prindëror, dhe që jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike.
 3. Familjet në varfëri ekstreme, pavarësisht të ardhurës të ndonjë pensioni minimal të një të afërmi dhe që kanë probleme ekonomike.
 4. Gratë e divorcuara, që kanë fëmijë dhe jetojnë tek të afërmit, por që nuk kanë të ardhura.
 5. Familje të varfëra që jetojnë në banesa me rrezikshmëri shembje dhe pa asnjë kusht higjeno-sanitar.
 6. Gratë e veja që janë me pension minimal familjar, që kanë fëmijë në shkollë dhe që jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe sociale.

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

7. Familjet egjiptiane, që jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe higjeno-sanitare.
8. Familje të cilat kanë fëmijë të braktisur nga njëri prind, dhe që jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike.
9. Gratë e veja, të divorcuara, pa pension dhe që nuk kanë përkujdesje të fëmijëve.
10. Gratë e divorcuara dhe të veja në moshë të madhe, (rreth 60-vjeç), që kanë probleme social-ekonomike.
11. Familje me kryefamiljarë invalidë pune, person me aftësi të kufizuar dhe që kanë fëmijë.
12. Persona të vetmuar (beqar, i ve, ose i divorcuar), që nuk kanë të ardhura.
13. Familjet e ngjuara të vërtetuara me dokument nga policia e shtetit.

B. Do trajtohen me ndihmë ekonomike, nga buxheti vendor.

1. Familje të cilat janë penalizuar nga mungesa e informacionit, gjatë aplikimit dhe deklarimeve të cilët janë në nevojë.
2. Familjet të cilat janë penalizuar për gabime të administratorëve shoqëror dhe nga verifikimet jo të sakta.

C. Nuk përfshihen në fondin 6% si më poshtë vijon:

1. Familjet të cilat janë refuzuar nga sistemi për arsye të deklarimeve të rreme nga vetë aplikuesit për një periudhë 6 - mujore, si dhe për 1 (një) vit, familjet të cilat kanë bërë 2 (dy) deklarime të rreme radhazi, refuzojnë ofertat e punësimit dhe largohen me dëshirë nga puna.
2. Familjet të cilat nuk jetojnë, në teritorin e njërive administrative të bashkisë Mirditë në mënyrë faktike pavarësisht banimit me dokumenta.
3. Familjet (personat) me të ardhura mujore mbi 45 000 lekë/në muaj.

D. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë, (agjencia e shërbimeve sociale, arsimit dhe kulturës (ASHSAK) dhe drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat).

Ky vendim hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.


SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ




KRYETAR

Aleksandër PICAKU





**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 172/2 Prot.

Rrëshen më, 02 . 02 . 2024

V E N D I M

Nr. 2 datë 31. 01. 2024

PËR

MIRATIMIN, E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE, NGA FONDI I KUSHTËZUAR, PËR BLOK - NDIHMËN DERI NË 6 %, PËR PERIUdhËN 01 – 31 DHJETOR 2023”, BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 7, i ligjit nr.7/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar, për ndihmën ekonomike”, në *Vendimin nr. 3, datë 31.01.2023, të këshillit bashkiak Mirditë*, kryetari i bashkisë, i propozon këshillit bashkiak Mirditë, projekt-vendimin për familjet aplikuese, që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit, të cilat do trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën deri 6 %, pas verifikimit real nga administratorët social, të çdo njësie administrative, muaj **DHJETOR 2023:**

- 1. Përmbledhëse e muajit DHJETOR 2023, të përfitimit të ndihmës ekonomike, nga fondin e kushtëzuar, për bllok-ndihmën deri në 6%, sipas njësive administrative.**

Nr.	Bashkia Mirditë / njësitë administrative	Gjithësej numri i familjeve dhe fondi		Komp.energjisë elektrike 6%		Totali
		Nr. Fam.	Fondi 6%	Nr. familjeve	Fond EN+Shkollë	6%+EN+Shkollë
				Përfituesëve	Lekë	Lekë
1	RRËSHEN	34	105 681	20+1	25 760+300	131 741
2	OROSH	10	32 728	6	7 728	40 456
3	FAN	9	25 556	2	2 576	28 132
4	SELITË	5	17 279	3	3 864	21 143
5	RUBIK	20	58 191	13+1	16 744+300	75 235
6	KTHELLË	6	22 372	5	6 440	28 812
7	KAÇINAR	14	36 640	2	2 576	39 216
	TOTAL	98	298 447	51+2	65 688+600	364 735

- 2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë; (agjencia e shërbimeve sociale, arsimit dhe kulturës - sektori ndihmës ekonomike).**

Ky vendim hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

email:keshilli@bashkiamirdite.gov.al



tel dhe fax : (00355)00 2162233

KRYETAR

Aleksandër PICAËU

www.bashkiamirdite.gov.al



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 296/2 Prot.

Rrëshen më, 02 . 02 . 2024

V E N D I M

Nr. 3 datë 31. 01. 2024

P Ë R

**MIRATIMIN, E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE, PËR BLOK –
NDIHMËN, ME FONDIN E BASHKISË, PËR PERIU DHËN 01 - 31 DHJETOR 2023”,
BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 7, i ligjit nr.7/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar, për ndihmën ekonomike”, në *Vendimin nr. 3, datë 31.01.2023, të këshillit bashkiak Mirditë*, kryetari i bashkisë, i propozon këshillit bashkiak Mirditë, projekt-vendimin për familjet aplikuese, që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit, të cilat do trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën, me fondin e bashkisë, pas verifikimit real nga administratorët social, të çdo njësie administrative, - **DHJETOR 2023:**

1. Përmbledhëse e muajit DHJETOR 2023, të përfitimit të ndihmës ekonomike, për bllok-ndihmën, me fondin e bashkisë sipas njësive administrative.

Nr.	Bashkia Mirditë / njësitë administrative	Gjithësej numri i familjeve dhe fondi		Komp.energjisë elektrike		Totali
		Nr. Fam.	Fondi	Nr. familjeve	Fond EN+Shkollë	EN+Shkollë
				Përfituesëve	Lekë	Lekë
1	RRËSHEN	28	120 410	19	24 472	144 882
2	OROSH	5	18 515	5	6 440	24 955
3	FAN	2	16 344	2	2 576	18 920
4	SELITË	3	15 228	1	1 288	16 516
5	RUBIK	6	28 508	5	6 440	34 948
6	KTHELLË	4	28 568	4	5 152	33 720
7	KAÇINAR	3	17 487	1	1 288	18 775
	TOTAL	51	245 060	37	47 656	292 716

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë; (agjencia e shërbimeve sociale, arsimit dhe kulturës - sektori ndihmës ekonomike).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICA KU



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 428/2 Prot.

Rrëshen më, 02 . 02 . 2024

V E N D I M

Nr. 4 datë 31. 01. 2024

PËR

“DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KALIMIN NË PRONËSI TË SIPËRFAQES PREJ 3.8 HA E LLOJIT TOKË TRUALL, NGA MINISTRIA E MBROJTJES NË BASHKINË MIRDITË, PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE TË REJA PUBLIKE TË BASHKISË MIRDITË.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.2 shkronja “a”, nenit 54 shkronja “e” të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 1, shkronjat “ç” dhe “dh”, neni 23 pika 28, neni 15 pika 1.2.2, neni 23 pika 4, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), pasaportës teknike ndërtimore me kodin MR_UB_V1_356/2 bashkëlidhur Vendimit nr. 2, datë 08.03.2023 “Për miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Mirditë, të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 20.06.2018” të Këshillit Kombëtar të Territorit, i ndryshuar, si dhe relacionin me nr. 428 prot, datë 31.01.2024, sëbashku me projekt –vendimin e paraqitur nga kryetari i bashkisë (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit), në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak në seancë,

V E N D O S I:

1. Miratimin, Për dhënie e pëlqimit për kalimin në pronësi të sipërfaqes prej 3.8 Ha e llojit tokë truall, nga Ministria e Mbrojtjes në Bashkinë Mirditë, për ndërtimin e Varrezave të reja publike të Bashkisë Mirditë.
 - Prona që jepet pëlqimi për kalim në pronësi në bashkinë Mirditë ka një sipërfaqe prej 3.8 Ha, që ndodhet në pasurinë nr. Pas 255/7, Zona Kadastrale 2769, fshati Ndërfushaz, Nj. Administrative Rrëshën, 4601, Bashkia Mirditë.
2. Bashkëlidhur, relacioni nr. 428 prot, datë 31.01.2024, plani i rilevimit Sh 1: 2, 500, me indeks htr K-34-76-(172-B), pasaporta teknike ndërtimore shoqëruar me hartën e parashikimit të përdorimit të tokës referuar Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) Mirditë, si dhe shkresa nr. 487 prot, datë 26.04.2023 e Zyrës Vendore ASHK Mirditë, pjesë përbërse e këtij vendimi.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë (DPZHT).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAË



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 428/1 Prot.

Rrëshen më, 31.01. 2024

P/VENDIM

Nr. 17 datë 31.01. 2024

PËR

“DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KALIMIN NË PRONËSI TË SIPËRFAQES PREJ 3.8 HA E LLOJIT TOKË TRUALL, NGA MINISTRIA E MBROJTJES NË BASHKINË MIRDITË, PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE TË REJA PUBLIKE TË BASHKISË MIRDITË.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.2 shkronja “a”, nenit 54 shkronja “e” të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 1, shkronjat “ç” dhe “dh”, neni 23 pika 28, neni 15 pika 1.2.2, neni 23 pika 4, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), pasaportës teknike ndërtimore me kodin MR_UB_V1_356/2 bashkëlidhur Vendimit nr. 2, datë 08.03.2023 “Për miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Mirditë, të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 20.06.2018” të Këshillit Kombëtar të Territorit, i ndryshuar, si dhe relacionin me nr. 428 prot, datë 31.01.2024, sëbashku me projekt –vendimin e paraqitur nga kryetari i bashkisë (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit), në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak në seancë,

VENDOSI:

1. **“Dhënie e pëlqimit për kalimin në pronësi të sipërfaqes prej 3.8 Ha e llojit tokë truall, nga Ministria e Mbrojtjes në Bashkinë Mirditë, për ndërtimin e Varrezave të reja publike të Bashkisë Mirditë.**
 - Prona që jepet pëlqimi për kalim në pronësi në bashkinë Mirditë ka një sipërfaqe prej 3.8 Ha, që ndodhet në pasurinë nr. Pas 255/7, Zona Kadastrale 2769, fshati Ndërfushaz, Nj. Administrative Rrëshën, 4601, Bashkia Mirditë.
2. Bashkëlidhur relacioni nr. 428 prot, datë 31.01.2024, plani i rilevimit Sh 1: 2, 500, me indeks htr K-34-76-(172-B), pasaporta teknike ndërtimore shoqëruar me hartën e parashikimit të përdorimit të tokës referuar Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) Mirditë, si dhe shkresa nr. 487 prot, datë 26.04.2023 e Zyrës Vendore AShK Mirditë.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë (DPZHT).
Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (të ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

Paraqiti Projektin:

Drejtori i Planifikimit Zhvillimit Territorit: Ing. Genc VLADI

Drejtori Juridik:

Besian DEDAJ

KRYETARI
Albert MËLYSHI



BASHKIA MIRDITË

Nr. 428 Prot.

Rrëshen, më 31.01.2024

Lënda : **Relacion mbi projektin për “Dhënie e pëlqimit për kalimin në pronësi të sipërfaqes prej 3.8 Ha e llojit tokë truall, nga Ministria e Mbrojtjes në Bashkinë Mirditë, për ndërtimin e Varrezave të reja publike të Bashkisë Mirditë**

Drejtuar: **KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË,**

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.2 shkronja “a”, nenit 54 shkronja “e” të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 1, shkronjat “ç” dhe “dh”, neni 23 pika 28, neni 15 pika 1.2.2, neni 23 pika 4, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), pasaportës teknike ndërtimore me kodin MR_UB_V1_356/2 bashkëlidhur Vendimit nr. 2, datë 08.03.2023 “Për miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Mirditë, të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 20.06.2018” të Këshillit Kombëtar të Territorit, i ndryshuar, mbi projektin për **“Dhënie e pëlqimit për kalimin në pronësi të sipërfaqes prej 3.8 Ha e llojit tokë truall, nga Ministria e Mbrojtjes në Bashkinë Mirditë, për ndërtimin e Varrezave të reja publike të Bashkisë Mirditë, ju informojmë si vijon:**

- Zona me kodin e MR_UB_V1_356/2 me Vendimin nr. 2, datë 08.03.2023 “Për miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Mirditë, të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 20.06.2018” të Këshillit Kombëtar të Territorit, i ndryshuar, **është miratuar si zonë studimore për ndërtimin e varrezave të reja publike**, si mungesë e hapësirë në varrezat ekzistuese në ndodhur hyrje të qytetit të Rrëshenit. Pas studimit të zonës në vendin ekzistues ishte e pamundur zgjerimi ndaj është zgjedhur zona e sipërcituar për shkak se ndodhet afër rrugës dhe plotëson kondicionet urbanistike për objektin “Ndërtim i varrezave të reja publike të Bashkisë Mirditë”. **Më poshtë ju paraqesim edhe treguesit e zhvillimit të pasaportës teknike ndërtimore, si dhe shoqëruar me hartën e planifikimit të territorit të miratuar:**

Njësia Strukturore: MR_UB_V1_356/2

Bashkia Mirditë

Njësia: MR_UB_V1_356/2

Sistemi UB_Urban

Kategori I V. Varreza 100%

PDV JO

Sipërfaqe (ha) 3.88

Nenkategori I V.1_Varrezë

Përdorime të Ndalura Ndalohen të gjitha përdorimet që nuk janë në përputhje me ato më sipër



Plani i Përgjithshëm Vendor



1/30/2024, 9:46:20 PM

PDV e-Planifikimi

PDV në Fuqi

Njësitë Strukturore

IEN.Infrastruktura Energjetike

INT.Infrastruktura Transporti

N.Toke Natyrore

S.Sherbime


V.Varreza

PPV Rrjeti Rrugor i Propozuar

B. Rruge Interurbane Kryesore

C. Rruge Interurbane Dytësore

F. Rruge Lokale



Ing. Blenard Dudi
AKPT


- Bashkia Mirditë ka aplikuar për pajisjen me dokumentat e pronësisë me aplikimin nr 652, datë 26.04.2023, nga ku me shkresën 487 prot, datë 26.04.2023, të protokolluar me tonën nr. 1663 prot, datë 28.04.2023 na është komunikuar mbivendosje të krijuara midis produktit të kompanisë Datech (mbi regjistrimin e pyjeve në Bashkinë Mirditë) dhe dokumentacionit të administruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Mirditë, konkretisht regjistruar parcela me nr pasurie 255/7, Zona Kadastrale 2769 e llojit truall në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes. E njëjta zonë në produktin e Datech mban nr. pasurisë 293 Zona Kadastrale 2769 e llojit Pyll, në htr me indeks K – 31 76 – (172 – B) me shkallë Sh 1 : 2 500.



▪ Duke u nisur nga shkresa e AShK Mirditë, si dhe nga fakti që prona e sipërcituar është regjistruar në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes më datë 04.04.2005, Bashkia Mirditë me shkresën “Kërkesë për transferim prone” me nr. 1663/1 prot, datë 06.11.2023 i është drejtuar Ministrisë.

Kërkesa i është dërguar edhe me postë elektronike email nga adresa e kryetarit të bashkisë z. Albert MËLYSHI, nga ku institucionit tonë i është dhënë orientimi që si pjesë e dokumentacionit tekniko – ligjor duhet të jetë edhe Vendimi i Këshillit bashkiak për Miratimin e kalimit të pronësisë (dhënie pëlqimi).

- Për saktësimin e parcelës matjet u kryen me instrumentat GNSS të saktësisë së larte V. ± 15 mm, H. ± 8 mm i markës α – GEO, siç ilustrohet edhe në imazhet/fotot bashkëlidhur:





- Pas përpunimit të matjeve të realizuara në terren kemi përgatitur edhe planin e rilevimit Sh 1: 2500, duke eliminuar mbivendosjet mbi hartën kadastrale dhe saktësuar sipërfaqen prej 38000 m², e llojit truall sipas kartelës dhe htr treguese për parcelën kadastrale me nr. Pas 255/7, Zona Kadastrale 2769, fshati Ndërfushaz, Nj. Administrative Rrëshën, 4601, Bashkia Mirditë.
- Koordinatat kufi prone të pasurisë 255/7/1 ZK 2769 (sip 38000 m² truall) e kërkuar për marrje në pronësi nga pasuria 255/7 ZK 2769 (sip totale 119 455.15 m²) janë si vijon:

nr	X (N)	Y (E)
0	4628263.275	488926.563
1	4628223.706	488938.134
2	4628138.373	488923.331
3	4628127.359	488912.526
4	4628053.768	488881.568
5	4627952.065	488823.44
6	4627945.497	488771.375
7	4627937.57	488754.468
8	4627927.933	488747.037
9	4627935.305	488730.182
10	4627945.999	488648.672
11	4627988.768	488649.815
12	4628062.62	488679.577
13	4628069.561	488749.932
14	4628115.99	488792.267
15	4628138.244	488862.433
16	4628199.915	488898.469
17	4628245.942	488907.117

SISTEMI PROJEKTIMIT KRGJSH

Bashkëlidhur relacionit gjeni dokumentin e planit të rilevimit për punime kadastrale Sh 1: 2, 500, me indeks htr K-34-76-(172-B), si dhe shkresa nr. 487 prot, datë 26.04.2023 e Zyrës Vendore ASHK Mirditë. Përsa cituam më lart, mungesës së varreve në varrezat ekzistuese kërkojmë nga ana Juaj miratimin e në Këshillin bashkiak Mirditë të P/Vendimit “Për Dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të sipërfaqes prej 3.8 Ha e llojit tokë truall, nga Ministria e Mbrojtjes në Bashkinë Mirditë, për ndërtimin e Varrezave të reja publike të Bashkisë Mirditë, për ti paraprirë një zgjidhje afatgjatë dhe me interes të lartë publik për këtë çështje shumë sensiteve për komunitetin.

Me shumë respekt,

**TOPOGRAF:
GJON DLESHAJ**

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
P/SEKTORI
ING. BLENARD DUDI**

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHËN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



J. Marku
Bashkishtes
MIRDIË

Nr. 1663 Prot
Dt. 28.04.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
ZYRA VENDORE MIRDIË

Nr. 487 Prot.

Rrëshen më: 26.04.2023

Lënda: Përgjigje aplikimit nr. 652 datë 26.04.2023

Drejtuar: BASHKISË MIRDIË.

Për dijeni: MINISTRISË SË MBROJTJES.

Për dijeni: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ASHK TIRANE.

Në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Mirditë, është administruar me nr.652 Aplikimi AV 0 me datë 26.04.2023, nga Bashkia Mirditë e cila kërkon, regjistrimin e ekonomisë pyjore LE2300102c, të përcjelle me shkresën nr.4834 prot. datë 26.11.2020.

• Sa më sipër ju informojmë se pranë ZV ASHK Mirditë, në bazë të dokumentacionit hartografik bashkelidhur shkresës rezulton që, preket pasuria 255/7 dhe pasuria 255/8, të cilat rezultojnë si më poshtë në kartelat fizike të pasurisë së paluajtshme:

1. Pasuria me nr. 255/7 vol.3 faqe 94, ZK 2769, Fshati Ndërfushaz, lloji i pasurisë *Trull* me sipërfaqe 119 455.15 m2, me pronar Republika e Shqipërisë Ministria e Mbrojtjes, regjistruar me referencën nr.00054 datë 04.04.2005, dhe lëshuar çertifikatë pronësie me datën 04.04.2005, në bazë të VKM nr. 515 datë 18.07.2003.
2. Pasuria me nr. 255/8, vol.3 faqe 95, ZK 2769, Fshati Ndërfushaz, lloji i pasurisë *Pyll* me sipërfaqe 1 702 044.85 m2 me pronar *shtet*.

• Gjithashtu me VKM nr. 684 datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, Për transferimin në pronësi të bashkive të pycjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ishkomunave/bashkive, të ndryshuar” shtojca 43 nr. rendor 2723 nga kompania Datech –CSI Piemonte është bërë regjistrimi fillestar i pasurive pyjore duke hapur kartelet e pasurive me nr. 293 vol .4 faqe 44 , ZK 2769, Fshati Ndërfushaz, lloji i pasurisë *Pyll*, me sipërfaqe 382 991 m2, me pronar Bashkia Mirditë, *duke sjell mbivendosje mes 2 vendimeve te këshillit të*

Adresa: Rrëshen, Mirditë

Tel: 021622780

Enciolo Xhillolli
28.04.2023
[Signature]



ministrave, ndodhur në këto kushte deri në sqarimin e situatës ZV ASHK Mirditë, nuk mund të ofrojë shërbime për pasuritë e sipërcituara.

Duke ju falenderuar për bashkepunimin!
Me respekt!

PËRGJEGJËS ZYRE

KLAJDI DODAJ

**Klajdi
Dodaj**

Digitally signed by Klajdi
Dodaj
Date: 2023.04.26 15:45:19
+02'00'



Vulosur elektronikisht nga Zyra
Vendore Mirditë
Date: 2023/04/26 15:47:24 +02'00'
G90912026D2023042615471698014

Agjencia Shtetërore për Luftimin e Korrupsionit
Mirditë

Tel: 021622780

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Zyra Vendore Mirditë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2769004044
(Nga ____, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2769, Lloji i Pasurisë: PYLL, Nr. i Pasurisë: 293, Sipërfaqja Totale 382991 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-76-(172-B), Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia ____, Rruga ____, Ndërtesa Nr. __, SH/K 255, Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:
Fillestare 1 Leke (Akti Nr. VKM 684, Dt. 02/09/2020), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B - TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: Bashkia Mirditë, Nr. Identifikimi/NIPT K39004005W, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia MIRDITË, Rruga SHESHI "ABAT DOÇI", Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __
Pronari: BASHKIA MIRDITË, Nr. Identifikimi/NIPT ____, Pjesa Takuese 0/100, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia ____, Rruga ____, Ndërtesa Nr. __, SH/K 255, Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Vendim i KM (për kalim në pronësi të institucionit shtetëror/apo vendimet e shpronësimit), Nr. VKM 684, Datë: 02/09/2020
Regjistruar: Nr. 000234, Datë: 16/09/2020

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____, me Kod Unik ____.*

B/1 - TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____, Nr. __, Datë: ____
Përshkrimi i Objektivit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __, Datë: ____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: Të tjera, Emërtimi i Aktit: Akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr. 1249prot, Datë: 11/11/2021

Regjistruar: Nr. 000234, Datë: 11/11/2021

Përshkrimi: VIJON NGA VOL 3 FAQE 95

MBI KËTË PASURI NDODHEN KËTO PARCELA: LE23 00 102A,102B 47

F-VEPRIMET ME KARTELËN E PASURISË

Veprimet me Kartelën Kryer Nga: Aurora Administrator, Veprimi me Nr. Regjistrimi: 00000234, Datë: 23/10/2022

DREJTORI

Data e lëshimit 26/04/2023

Mirënjohje V. K. M. Nr. 509, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale: 2769 NR. I PASURISE: 255/7

Indeksi i Hartës: E-34-76-172-B1

Adresa e pasurisë: Rrethi MIRDITE Q/IF NDERFUJHAZ

Rr/L _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

PERFUNDIMTARE (data) 2005

Përshkrim i Veçantë

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N. : Jo ----> Po, Ref: _____

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë
1. <u>1194.5515</u> m ²	1. _____ m ²	1. _____ m ²
Ref <u>00054</u>	Ref _____	Ref _____
2. _____ m ²	2. _____ m ²	2. _____ m ²
Ref _____	Ref _____	Ref _____
3. _____ m ²	3. _____ m ²	3. _____ m ²
Ref _____	Ref _____	Ref _____
4. _____ m ²	4. _____ m ²	4. _____ m ²
Ref _____	Ref _____	Ref _____

Për pjesën e përbashkët:

PALLAT

Kuota e Pjesëmarrjes:

_____ %

Nr. i Pasurisë (Pallat):

Vol. _____ Fq. _____

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr Dok	Data Regjistrim	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
<u>00054</u>	<u>04.04.2005</u>	<u>SHIET</u>			<u>MIRDITE - NDERFUJHAZ</u>			<u>MIRDITE PA. NDE</u>	
<u>00054</u>	<u>04.04.2005</u>	<u>REPUBLIKA SHQIPERIE MINISTRIA MIREBETIMIT ADMINISTRIM K.M.Z NOT. KASHMORA DEKAD</u>	<u>250 33020</u>	<u>I</u>	<u>TIRANE</u>		<u>04.04.2005</u>	<u>REKORDI</u>	

Firma



BASHKIA MIRDITË

Nr. 1663/Prot.
L

Rrëshen, më 06.11.2023

Lënda: Kërkesë për transferim prone.
Drejtuar: **MINISTRISË SË MBROJTJES**
Rruga e Dibres, KP 2423

TIRANË

I nderuar Z. Ministër!

Si pasojë e nevojave komunitare dhe mungesës së varreve në varrezat ekzistues, **Bashkia Mirditë** për nevoja emergjente ka miratuar rishikimin e përshpejtuar të Planit të Përgjithshëm Vendor me nr. 11, datë 31.01.2023 në Këshillin bashkiak Mirditë. Gjithashtu nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit është lëshuar akti i përputhmërisë me nr. 61 prot, datë 13.01.2023. Në mbledhjen e datës 08.03.2023 të Këshillit Kombëtar të Territorit me Vendim nr. 2 “Për Miratimin e rishikimit të planit të përgjithshëm vendor, bashkia Mirditë, të Miratuar me Vendimin nr. 2, datë 20.06.2018”, i ndryshuar, ndaj **kërkojmë nga ana Juaj transferimin e pronës së ndodhur në njësinë strukturore të zhvillimit të territorit MR_UB_V1_356/2**. Kjo njësi strukturore përkon me rishikimin e PPV Mirditë dhe është **parashikuar për ndërtim të varrezave publike të qytetit Rrëshen**, pronarë të të cilit është Ministria juaj, sipas dokumentave bashkëlidhur shkresës të përcjella nga Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Mirditë.

Për këtë kërkojmë nga ana Juaj që për ti ardhur në ndihmë pushtetit vendor, kalimin në pronësi të Bashkisë Mirditë, të sipërfaqes prej 3.88 Ha të ndodhur në **pasurinë me nr. pas. 255/7, (sipas HTR), Zona Kadastrale nr. 2769 fshati Ndërfushaz** me qëllim ndërtimin e **varrezave të reja publike për qytetin Rrëshen** si dhe për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, **çka do të na ndihmonte jashtë mase për situatën në të cilën ndodhemi.**

Bashkëlidhur dokumentacioni i përcjellë nga AShK Mirditë, HTR/kadastrale, sipas PPV dhe pasaporta teknike e ndërtimit.
Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

KRYETARI

Albert M...





**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 224/Prot.
1

Prëshen më, 02 . 02 . 2024

V E N D I M

Nr. 5 datë 31. 01. 2024

**PËR
"TRAJTIM ME BURSË SHTETI PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME
PROFESIONALE INDUSTRIALE RUBIK, PËR VITIN SHKOLLOR 2023-2024",
BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, e ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", VKM nr. 666 datë 10. 10. 2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike" i ndryshuar, në shkresën nr. 4072 prot, datë 01. 11. 2023, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2023-2024" për bashkinë Mirditë janë miratuar **5 bursa**, me propozim të Kryetarit bashkisë (agjencia e shërbimeve sociale, arsimit dhe kulturës), për trajtimin me bursë, nxënësit që ndjekin shkollën e mesme profesionale - industriale Rubik, për vitin shkollor 2023-2024, këshilli bashkiak pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë për trajtim me bursë shteti për nxënësit e shkollës të mesme profesionale Rubik, **klasa 10**, të cilët janë të akomoduar në konvikt dhe ata që përfitojnë sipas VKM-së si vijon:

Nr.	Emër /	Atësi /	Mbiemër	Klasa	Dega	Përfiton bursë sipas VKM nr. 666 datë 10.10.2019 (i ndryshuar)
1	LEO	LUAN	CEKA	10	Termohidraulikë	pika 2.3 shkronja d

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (agjencia e shërbimeve sociale, arsimit dhe kulturës).

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

KRYETAR

Aleksandër PICA KU



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 429/1 Prot.

Rrëshen me, 02.02. 2024

V E N D I M

Nr. 6 datë 31. 01. 2024

PËR

**“MIRATIM E FONDEVE TË TRASHËGUARA (PJESORE), NGA BUXHETI
I VITIT 2023 PËR VITIN 2024”, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 68/2017, pika 3, neni 48, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 97/2023, datë 07.12.2023, "Për buxhetin e vitit 2024, "Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" i ndryshuar, në Udhëzimin nr. 23, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" në Aktin Normativ nr. 6, datë 14.12.2023, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023" të ndryshuar, Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" të ndryshuar, shkresë e MFE nr. 22656/6 prot, datë 20.12.2023, mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 6, datë 14.12.2023, me propozim të kryetarit të bashkisë, diskutimeve në Këshillin Bashkiak në seancë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondeve të trashëguara (pjesore), sipas Aktit Normativ nr. 6, datë 14.12.2023, + relacioni nr. 431, prot, datë 31.01.2024, në vlerën 23 500 000 lekë të detajuar si më poshtë vijon:

- 1) Rikonstruksion i tregut të fshatarëve;.....5 000 000 lekë.
- 2) Rikonstruksion i sheshit të qytetit Reps;.....2 000 000 lekë.
- 3) Blerje automjete APPM;.....15 000 000 lekë.
- 4) Rikonstruksion i ujësjellësit Fan (shtesë fondi);.....500 000 lekë.
- 5) Rikonstruksion i ujësjellësit Reps (shtesë fondi);.....500 000 lekë
- 6) Rikonstruksion i ujësjellësit Kthellë (shtesë fondi);.....500 000 lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor. nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.


SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICA KU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

Nr. 22636/Prot
6

Tiranë, më 20/12/2023

Lënda: Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.6, datë 14.12.2023

DEGËS SË THESARIT _____


DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT

BASHKISË Mirditë

Në zbatim të Aktit Normativ nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, ju dërgojmë detajimin e shtesës së fondeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore në transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme, sipas tabelës bashkëlidhur, në lekë. Ju bëjmë me dije se, kjo transfertë në radhë të parë përdoret për shlyrjen e detyrimeve të prapambetuara dhe pasi të jenë shlyer detyrimet përdoret për shpenzime të tjera. Kjo transfertë nuk përdoret për shpenzimet e rindërtimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 6, datë 14.12.2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023".

Ent. Qev.	Mim. Liraj	Kodi Inst.	Emër Inst.	Kap.	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi Thesarit	në lekë
